

28.04.2023

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Ushqimesh

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **03222111-4:03333000-4:15411200-4:15530000-2:15612120-8:158811100-7:15850000-7.**

VLERA E FONDIT LIMIT: : 1 916 666,66 (Njemilion e nenteqind e gjashtembedhjetemije e gjashteqind e gjashtedhjetegjashte presje gjashtedhjetegjashte) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Bulqize hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76 pika 1, 82 pika 1 dhe 83 pika 1 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë:

Sipas kritereve të përgjithshme për kualifikim shtojca 7.

Argumentimi: Në bazë të pikës 2 dhe 4, të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publiksi dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerësëparashikuartëkontratës. Kjo kerkese konsiderohet e permbushur nëq Operatorët Ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, tëVKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet me qëllim vlerësimin e situatës ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht të disponimit të kapaciteteve ekonomike dhe financiare për të realizuar me sukses kontratën dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr.285 datë 19.05.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.2.2.Kopje të vërtetuara të bilanceve vjetore të viteve 2019, 2020, 2021 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore , të konfirmuara nga ky autoritet që te tregojne raportet midis aktivitet dhe pasivitet, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “ Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” dhe nenit 29, pika 1, të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 , në të gjitha adresat ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

* *Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të LPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentin e lartpërmendur.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljessënjofitimitkontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislativitetit në fuqi ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislativitetit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet me qëllim vlerësimit të përvojës së mëparshme të operatorit ekonomik në mallrat objekt kontrate dhe është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 55, pika 4/b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

-
- Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **mostrat (kampionet) ditën e hapjes së ofertave në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit**, nga jo më pak se një 1 (një) kampion në paketim origjinal për produktet (**buke, makarona, maje birre, miell gruri, oriz, qumesht, vaj**) objekt prokurimi.

Mostrat e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues. Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara

Mosparaqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike të kërkuara është kusht s’kualifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

- Operatori ekonomik duhet te paraqesi vertetim per numrin mesatar te punonjesve per periudhen kohore Tetor 2022 –Janar 2023 jo me i vogel se 2 punonjes, i vertetuar nga organet tatimore per te mundesuar realizimin e kontrates me sukses.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- a) Vërtetim të lëshuar nga administrate tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

Argumentimi: Nëbazëtëpikës 4, tënenittë 77, tëligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Përprokuriminpublik” dhenenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Përmiratimin e RregullavetëProkurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses te kontrates.

- Operatori ekonomik duhet te paraqesi vertetim per numrin mesatar te punonjesve per periudhen kohore Tetor 2022 – Janar 2023 jo me i vogel se 2 punonjes, i vertetuar nga organet tatimore per te mundesuar realizimin e kontrates me sukses.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- c) Vërtetim të lëshuar nga administrate tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .
- d) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përlllogaritur në raport me sasitë e mallrave që do të furnizohen, numrin e mjeteve që kërkohen të vihen në dispozicion për përmbushjen e kontratës dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

- Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (nje) mjet transporti, për transportin e produkteve ushqimore, në pronësi apo të marrë me qira, të vërtetuar me dokumentacionin përkatës (certifikate pronësie ose kontrate qeraje noteriale), leje qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjetit, lejet e drejtimit të drejtuesve të mjeteve.

* *Kriteret për disponimin e mjeteve dhe punonjësve do të konsiderohen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartpërmendura.*

Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicionmjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet:

“ Kodi rrugor I Republikës së Shqipërisë” indryshuar , neni 92 parashikon shprehimisht se “Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një lejeqarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.”

“ Kodi rugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar , neni 79/3 parashikon shprehimisht se “Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik”

Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009 “ Përsigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” neni 4 parashikon shprehimisht se: “Pronari i çdo mjeti transporti, përparapërdorim të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij ligji, sidhetësigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti transportit do të mbetet në qarkullim.”

* *Kriteret për disponimin e mjeteve dhe punonjësve do të konsiderohen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, referuar nenit 82 të LPP-së dhe nenit 26, pika 1 të RPP-së. Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të paraqesë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e lartpërmendura.*

Mospërputhjet ndërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbëjnë kusht për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

** Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

NJESIA E PROKURIMIT